

***SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE***

***“Bega-07” shpk***

***(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2022)***

---

**“Bega-07” Shpk**

**SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

**(te Ushtrimit te mbyllur me date 31.12. 2022)**

**16 Mars 2023**

## ***SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE***

***“Bega-07” shpk***

***(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2022)***

### **Informacion i përgjithshëm.**

Shoqëria “Bega-07” shpk është themeluar date 12.09.2007, regjistruar në Drejtorine Rajonale Tatimore Fier, me nipt K73312401J.

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare” i ndryshuar, nga statuti dhe Legjislacioni ne fuqi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë “Bega-07” shpk është: Punime murature, karpentier, armatur, veshje pllakash, hekurkthyes etj. Shitje kancelari me shumice dhe pakice si dhe studio projektimi. Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, ndertesa shumekateshe, rikonstruksione, punime mirembajtje, sherbime fasade. Ndertim rrugeshe dhe punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, asfaltim dhe veshje me asfaltim, urash, vepra arti, si dhe ndertime portuale, detare dhe ajrore dhe rikonstruksionin e tyre. Ndertim vepra kullimi, ujitje, ujesjellsa dhe kanalizimesh, punime hidraulike, elektrike etj. Ndertimi ambiente dhe sistemim gjelberimi, parqe e lulishte. Tregtim me shumice dhe pakice. Import ekport te artikujve te ndryshem industriale, ushqimore, elektroshtepiake, elektrike, hidraulike, kimike, tekstile, mobilje. Projektim i objekteve sportive te mbuluara ose pjeserisht te mbuluara. Qendra tregtare, objekte social kulturore, objekte arsimore. Ushtrimin e profesionit Ekspert Zjarrefikes leshuar me Nr. 2093, date 15.03.2017. Studimi dhe pergatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te cdo lloji. Tregtim dhe montim te paisjeve dhe aksesoreve per ambientet frigoriferike. Ndertim sera diellore, tregtim dhe kompletim te paisjeve dhe aksesoreve per to. Tregtim Tонера per Printera te modeleve te ndryshme. Bar- kafe, restorant, hotel.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është z. Arben Muçobega.

Selia e Shoqërisë është në Lagjja: “16 Prilli”, Rruga “Leon Rei”, Pallati Bega-07, prane stadiumit “Loni Papuçiu”, Fier.

### **Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

Deklarata e pajtueshmërisë: Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Bazat e matjes: Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

Biznesi në vijimësi: Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes: Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Leke, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të



## **SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

**“Bega-07” shpk**

**(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2022)**

krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

### **Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### **Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatit e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

### **Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

### **Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

Transaksionet në monedhë të huaj.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi



## **SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

**“Bega-07” shpk**

**(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2022)**

në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2022	2021
Euro/LEK	114.23	120.76
USD/ LEK	107.05	106.54

### Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogaritë pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme



## **SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

**“Bega-07” shpk**

**(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2022)**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### **Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

### **Aktive afatgjata materiale**



## **SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

### **“Bega-07” shpk**

**(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2022)**

#### **i. Njohja dhe matja**

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **ii. Kostot e mëpasshme**

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### **iii. Amortizimi**

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2022 dhe 2021 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndertesat	Vlera e mbetur	5%
Mjete pune	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Paj, zyre e informat	Vlera e mbetur	20%

#### **iv. Çregjistrimi**

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

Të ardhurat



## **SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

**“Bega-07” shpk**

**(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2022)**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

Qiratë

Qiramarjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 15% (2021: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.



## **SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

**“Bega-07” shpk**

**(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2022)**

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

### Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

### Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

### Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

### Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

## **AKTIVET AFATSHKURTRA**

**Aktive monetare** për 84.157.444 lekë, perfaqesojne mjete monetare ne banke.

Shoqëria operon me disa banka, te gjitha veprimet jane rregjistruar ne ditaret perkates, me llogarite ne valute veprimet jane kryer me kursin ditor te bankes, ndersa gjendja e monedhave te huaja ne fund te ushtrimit eshte vleresuar me kursin e Bankes se Shqiperise me date 31.12.2022 duke kaluar sipas rastit ne llogarite e shpenzimeve apo te ardhurave diferencat e kembimit.





## **SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

**“Bega-07” shpk**

**(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2022)**

**Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit** në vlerën 1.309.750.260 leke perfaqeson llogarine Kliente per vleren e faturave te paarketuara. Kjo llogari eshte e analizuar sipas klienteve dhe rakordon me llogarine sintetike te tyre. Ne kete post jane paraqitur edhe kostot e pallateve ne ndertim te pashitura ne 31.12.2022.

**Te tjera te drejta te arketueshme** ne shumen 116.628.231 leke paraqesin:

- **Tvsh** ne shumen 1.021.922 leke.
- **Tatim fitimi** ne shumen 201.786 leke.
- **Garanci** ne shumen 310.750 leke.
- **Te tjera** ne shumen 115.093.773 leke, detyrim te te treteve ndaj shoqerise.

Ne llogarite **Inventariale** ne shumen 7.392.958 leke shoqeria ka paraqitur gjendjen e lendeve te para dhe materialeve te konsumueshme si edhe gjendjen e inventarit te imet. Vleresimi i tyre ne fund te ushtrimit eshte bere me kosto faktike.

**Parapagime** per furnizime ne shumen 1.891.976 leke.

**Shpenzime te shtyra** ne shumen 231.974.960 leke jane shpenzime per pagesat e taksave te infrastruktures, sherbime projektimi, etj.

### **Aktivet afatgjata materiale**

Shoqëria ka një vlerë neto aktive sh afatgjata materiale ne shumen 153.389.811 lekë e cila perfaqeson vleren e mbetur te hotelit, mjeteve te punes, mjeteve te transportit dhe pajisjeve te zyres e informatike. Aam jane shtuar gjate vitit 2022 ne shumen 5.785.774 leke, shtesat jane ne zerat : Makiner, paisje dhe vegla pune 4.661.883 leke, Mjete Transporti 477.160 leke, Paisje Informatike 244.901 leke. Aktivet afatgjata materiale jane pakesuar per amortizimin e llogaritur ne shumen 14.672.016 leke si edhe vleren e mbetur te aam-ve te shitura ne shumen 6.134.119 leke

### **DETYRIMET DHE KAPITALI**

**Kapitalet e veta** paraqiten me vlerë 251.541.586 leke.

**Kapitali i rregjistruar** i shoqërisë është 100.000 lekë, i perbere nga nje kuote e cila i perket ortakut te vetem te shoqerise z. Arben Muçobega.

**Rezerva ligjore** ne shumen 7.194.750 leke e pandryshuar nga viti kaluar.

**Rezerva te tjera** ne shumen 196.673.496 leke eshte shtuar me fitimin e vitit 2021 ne shumen 40.603.320 leke sipas vendimit te ortakeve mbi miratimin e pasqyrave financiare 2021 date 28.06.2022.

**Fitimi i ushtrimit** sipas bilancit kontabël paraqitet ne shumen 37.573.340 lekë.

### **Detyrimet**

Detyrimet me vlerë 1.663.644.054 lekë përfaqësojnë:



## **SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

**“Bega-07” shpk**

**(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2022)**

	<u>Viti 2022</u>	<u>Viti 2021</u>
Detyrime ndaj institucioneve te kredise	38.033.113	31.713.701
Arketime ne avance per porosi	984.352.347	812.266.158
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	508.978.925	221.215.808
Te pagueshme ndaj punonjesve e sigurimeve shoqerore	12.916.577	9.918.654
Detyrime tatimore	159.923	1.301.742
Te tjera detyrime	119.203.169	30.584.686
<b>Totali</b>	<b>1.663.644.054</b>	<b>1.107.000.749</b>

**Detyrime ndaj institucioneve te kredise** ne shumen 38.033.113 leke paraqet hua te marra ne:

- Overdraft ne OTP banke 3.106.817 leke,
  - Kredi ne BKT leke 22.421.427 leke,
  - Kredi ne OTP leke 1.973.786 leke,
  - Kredi ne BKT leke 1.302.083 leke,
  - Kredi ne OTP leke 6.364.038 leke,
  - Kredi ne BKT leke 369.240 leke,
  - Kredi ne BKT leke 2.495.722 leke
- Totali 38.033.113 leke

Gjendja e huas ne monedhe te huaj eshte konvertuar me kursin e bankes se Shqiperise date 31.12.2022.

**Arketime ne avance per porosi** ne shume 984.352.347 leke paraqet parapagimet per blerjet e apartamenteve, njesive tregtare dhe garazheve e cila ne pasqyrat financiare eshte e ndare ne afatshkurtra ku kemi perfshire parapagimet e bera pas vitit 2015 per te cilat jane prere fatura tatimore ne shumen 853.776.435 dhe parapagime me te hershme ne afatgjata ne shumen 130.575.912 leke.

**Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit** per 508.978.925 leke paraqesin llogarine furnitore per vlerën e faturave të palikujduara. Kjo llogari eshte e analizuar sipas furnitoreve dhe rakordon me llogarine sintetike te tyre.

**Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore** paraqitet detyrimi i shoqerise per paga ne shumen 12.394.213 leke dhe ndaj sigurimeve ne shumen 522.364 leke.

**Detyrimet tatimore** paraqesin:

- **Tatimi mbi pagen** per 55.523 leke, detyrim per muajin dhjetor 2022.
- **Tatim ne burim** ne shumen 104.400 leke.

**Te tjera kerkesa** ne shumen 119.203.169 leke paraqet detyrim te shoqerise ndaj te treteve.

### **Verifikimi i llogarise Fitime Humbje**

Shpenzimet dhe të ardhurat janë grupuar si më poshtë:



## ***SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE***

***“Bega-07” shpk***

***(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2022)***

	Viti 2022	Viti 2021
<b>Te ardhura</b>		
Nga shitja e mallrave dhe sherbimeve	513.329.389	512.748.739
Te ardhura te tjera nga vepr. shfrytez	4.665.000	1.962.000
Prodhimi i aam-ve		
<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>517.994.389</b>	<b>514.710.739</b>
Pakesim i gjendjes se produktit te gatshem		
Materiale te konsumuara	385.655.631	396.957.245
<b>Kosto e punes</b>	<b>27.786.914</b>	<b>21.749.425</b>
Pagat e personelit	23.698.545	18.537.821
Shpenzimet per sigurime	4.088.369	3.211.604
Amortizimi dhe zhvleresimet	14.672.016	12.811.340
Shpenzime te tjera	41.739.456	33.002.097
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>469.854.017</b>	<b>464.520.107</b>
Te ardhura te tjera nxitje punesimi		
Diferencat nga kembimi	(1.582.628)	(227.677)
Shpenzime interesi	(2.298.143)	(2.072.327)
<b>Fitimi bruto</b>	<b>44.259.601</b>	<b>47.890.628</b>
<b>Tatim fitimi</b>	<b>(6.686.261)</b>	<b>(7.287.308)</b>
<b>Fitimi neto</b>	<b>37.573.340</b>	<b>40.603.320</b>

Shpenzimet jane 473.734.788 leke, ndersa te ardhurat 517.994.389 lekë. Rezultati neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj gjate ketij viti ushtrimor është fitim ne shumen 37.573.340 leke.

Te ardhurat e realizuara gjate ushtrimit perfaqesojne: te ardhura nga shitja e sherbimeve ne shumen 314.694.172 leke, te ardhura nga shitja e apartamenteve ne shumen 198.635.217 leke, te ardhura nga qerate 1.640.000 leke dhe te ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata materiale ne shumen 3.025.000 leke.

Shitjet jane rregjistruar korrekt ne librat e shitjeve dhe te ardhurat rakordojne me situaten tatimore.

**Shpenzimet** per 473.734.788 lekë, jane te justifikuara me dokumenta te rregullta fiskale. Më konkretisht shpenzimet sipas zërave janë si më poshtë:

**Shpenzime per materiale** ne shumen 385.655.631 lekë, ato janë përdorur për veprimtarinë kryesore të shoqërisë, këto shpenzime janë të justifikuara me dokumenta te rregullta tatimore. Ne kete post kemi paraqitur edhe koston e ndertimit te apartamenteve, njesive dhe garazheve te shitura, si edhe shpenzimet per tu shpendare per objektet e shitura.

**Personeli**, në këtë llogari janë pasqyruar shpenzimet për paga 23.698.545 lekë, sigurime shoqërore 4.088.369 lekë, listëpagesat janë përpiluar saktë dhe shpenzimet për paga e sigurime janë vendosur korrekt në këtë llogari. Nje permbledhese e tyre paraqitet:



# **SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

**“Bega-07” shpk**

**(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2022)**

MUAJ	[15] Paga Totale bruto në lekë	[16] Paga Bruto mbi të cilën llogariten kontributet e sigurimeve shoqërore	[17] Kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme të punëdhënësit	[18] Kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme të punëmarrësit	[25] Kontribute për sigurimet shëndetësore gjithsej	Total sigurime Shoq shend	[26] Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi (TAP) gjithsej në lekë	SIGURIME+T AP	NR. PUNONJES
JANAR	1,807,991	1,868,608	279,325	177,405	63,534	520,264	65,812	586,076	47
SHKURT	1,823,700	1,884,317	281,681	178,899	64,069	524,649	66,964	591,613	47
MARS	2,061,240	2,121,857	317,310	201,463	72,147	590,920	69,167	660,087	54
PRILL	1,843,400	1,914,290	286,103	181,746	65,088	532,937	48,245	581,182	52
MAJ	1,716,961	1,787,454	267,089	169,689	60,780	497,558	51,303	548,861	46
QERSHOR	2,178,556	2,249,049	336,330	213,536	76,477	626,343	56,412	682,755	58
KORRIK	2,350,962	2,421,455	362,190	229,918	82,337	674,445	55,523	729,968	66
GUSHT	2,398,107	2,468,600	369,263	234,395	83,941	687,599	56,578	744,177	64
SHTATOR	1,973,118	2,055,245	307,188	195,129	69,879	572,196	54,605	614,226	46
TETOR	1,915,769	1,997,896	298,584	189,678	67,929	556,191	58,035	569,552	43
NETOR	1,776,561	1,860,958	278,046	176,667	63,274	517,987	55,523	592,417	44
DHJETOR	1,852,180	1,928,722	288,211	183,104	65,579	536,894	689,732	7,527,715	52
<b>TOTALE</b>	<b>23,698,545</b>	<b>24,558,451</b>	<b>3,671,320</b>	<b>2,331,629</b>	<b>835,034</b>	<b>6,837,983</b>			

**Amortizimi** ne shumen 14.672.016 leke nuk kalon kufijte tatimor.

**Shpenzime te tjera** per 41.739.456 leke paraqesin:

- shpenzime per energji elektrike dhe uje ne shumen 3.837.642 leke,
- shpenzime per qera ne shumen 696.000 leke,
- shpenzime mirembajtje dhe riparime ne shumen 2.202.301 leke,
- shpenzime komisioni banke ne shumen 995.892 leke,
- shpenzime per taksa ne shumen 2.819.310 leke,
- shpenzime per siguracione ne shumen 1.500.474 leke,
- shpenzime djeta ne shumen 10.663.581 leke,
- shpenzime subvencioni ne shumen 59.915 leke,
- shpenzime gjoba ne shumen 315.471 leke,
- shpenzime auditimi ne shumen 360.000 leke,
- mbikqyres punimesh punonjes i jashtem ne shumen 600.000 leke,
- shpenzime per karburant ne shumen 1.824.478 leke,
- shpenzime reklame 142.150 leke,
- kanceleri +projekte ne shumen 1.594.136 leke,
- shpenzimi regjistrimi ne hipoteke dhe noteriale 1.821.521 leke,
- rezervime me booking ne shumen 1.902.411 leke,
- shpenzime telefoni ne shumen 231.330 leke,
- vlere ae mbetur e aam-ve te shitura ne shumen 6.134.119 leke,
- shpenzime te tjera ne shumen 4.038.725 leke, ketu perfshihen shpenzime per kanceleri, ruajtje objekti, mirembajtje prog, shpenzime perfaqesimi, vnm etj.

**Shpenzime financiare** ne shumen 3.880.771 leke paraqet shpenzime interesi per huat e marra ne shumen 2.298.143 leke dhe interesa negative kembimi ne shumen 1.582.628 leke.

**Rezultati ushtrimor** neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj është fitim 37.573.340 leke.



## **SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

**“Bega-07” shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2022)**

---

### **Ngjarje pas datës së Bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Pasqyrat financiare jane përgatitur mbi supozimin e biznesit në vijimësi, dhe drejtimi mendon se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

**Administrator**  
Arben Muçobega

*Arben Muçobega*

